



REPUBLIKA E SHQIPERISË
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Nr. 4801/3065/2322 Regj. Themeltar.
Nr. 352 Vendimi

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Apelit Tiranë e përbëre nga:

KRYESUES : Gramoz LEVANAJ
ANETAR : Ridvan HADO
ANETAR : Asim VOKSHI

Me sekretare gjyqësore [REDACTED] sot, më date 25.11.2020, në seance gjyqësore mori në shqyrtim çështjen civile Nr.4801/3065/2322 akti, që i përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: [REDACTED] e bija e [REDACTED] dhe e [REDACTED] e dtl [REDACTED], lindur dhe banuese në [REDACTED] Rruga [REDACTED] pall nr. [REDACTED], e martuar, me shtetësi dhe kombesi shqiptare. Përfaqësuar në këtë gjykim me prokurë në prani dhe në mungesë nga Av. [REDACTED] me nr. [REDACTED]0 licencë, Dhoma e Avokatisë Lezhë.

IPADITUR: Shoqëria “ProtecShoes”shpk, përfaqësuar në këtë gjykim me prokurë te posacme nga Av [REDACTED]

PERSON I TRETË: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,(ne mungese).

OBJEKTI: Konstatimin e diskriminimit ndaj paditëses [REDACTED] nga ana e palës së paditur Shoqëria "Protect Shoes "sh.p.k. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Protec Shoes" sh.p.k të dëmshperblejë palën paditëse dhe familjarët e saj [REDACTED] dhe Ajsel Hidri për dëmin jopasuror me vlerë totale 6,046,336 lekë, sipas Raport Vlerësimi Psikologjik datë 31.10.2017.

BAZA LIGJORE: Neni 18 dhe 49 i Kushtetutës së Shqipërisë, neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 31, 32,153, 154 të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr.10221 dt. 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga Diskriminimi", neni 608, 625, 640 te Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin civil Nr. 152 datë 10.04.2018 ka vendosur si vijon:

- Pranimin e kërkesë-padisë së paditëses [REDACTED]
- Konstatimin e diskriminimit të paditëses [REDACTED], nga pala e paditur Shoqëria "Protec Shoes" shpk.
- Detyrimin e palës së paditur Shoqëria [REDACTED] "sh.p.k. të dëmshpërblejë paditësen [REDACTED] për dëmin jopasuror të pësuar nga pala paditëse [REDACTED] dhe familjarët e saj [REDACTED] dhe [REDACTED] me vlerë totale 6.046.326 lekë.
- Shpenzimet gjyqësore përfshirë taksat mbi aktet në vlerë 1 % (6.046.326) lekë, pagesa për psikologët në shumën 100.500 leke dhe shpenzimet e avokatit në vlerë 240.000 leke i ngarkohen palës së paditur..

Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim pala e paditur, përmes përfaqësuesit të saj, duke parashtruar shkaqet për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke prapësuar se:

- Vendimi Nr.152, datë 10.04.2018, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, i pambështetur në prova dhe në shkelje të njëpasnjëshme e të rënda procedurale, konkretisht: Gjykata ka konstatuar diskriminimin ndërkohe që ky konstatim ishte bërë me parë me vendimin Nr.146, date 24.09.2014 nga organi kompetent i ngarkuar me ligj Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Gjykata ripërsërit vendimin e Komisionerit, pa bërë asnjë hetim në lidhje me këtë fakt dhe dublon funksionin, ndërkohë që duhet të shprehej vetëm dhe vetëm për masën e dëmshpërblimit, referuar konstatimit të bërë nga Komisioni si një institucion i specializuar.
- Pikërisht fakti që Gjykata shprehet se konstaton diskriminim është shkejje e rëndë procedurale, madje lidhur me këtë konstatim gjykata gjatë gjithë procesit nuk ka asnjë hetim gjyqësor lidhur me konstatimin e diskriminimit.
- Padia ka objekt të gabuar, të tepërt kur kërkon konstatim të Diskriminimit, dhe Gjykata më pas kur e pranon padinë të plotë dhe konstaton në mënyrë të dubluar, pa hetim gjyqësor në lidhje me këtë pikë, duke bërë një shkelje të rëndë procedurale.
- Të dy ekspertët e caktuar nga Gjykata, nuk plotësojnë kushtet minimale për t'u zgjedhur të tillë. Kështu Ekspertja Psikologe [REDACTED] nuk ka patur të drejtën ligjore dhe profesionale për të ushtruar detyren e ekspertit psikolog në gjykatë pasi në momentin kryerjes së aktit të ekspertimit, nuk ishte pajisur me licence eksperti nga shoqata e Urdhrit të Psikologut. Pra akti i ekspertimit është paraqitur nga një person, i cili nuk e ka tagrin ligjor për të qenë ekspert psikolog në Gjykatë.
- Psikologja [REDACTED] paraqet në aktin e ekspertimit fakte të pavërteta, kështu ajo deklaron se paditësja që pas largimit nga puna, kurrë me nuk ka arritur të punojë dhe aktualisht është e papune, ndërkohë nga verifikimet e bëra për sigurimet e paguara në emër të paditëses, rezulton se ka lënë në mes dhe lejen e lindjes për t'u rikthyer me pagesë më lartë në tregun e punës.
- Në lidhje me themelin e çështjes është i pabazuar pretendimi i paditëses se ka qenë pa punë në periudhën pas lindjes, pasi referuar vërtetimit për bazën e vlerësuar për [REDACTED] i të marrë nga ISSH) e cila është administruar tashmë nga Gjykata, vërtetohet se paditësja në muajin Korrik të vitit 2013, ka filluar të punojë me pagë mujore 91.475 lekë, tek punëdhënësi shoqëria "BConnnect" shpk me NIPT L 31720003 A, e cila e ka qendrën në Tiranë, ndryshe nga sa deklorohet në aktin e ekspertimit që pas lindjes së femijës me datë 21.01.2013 për rreth 1 vit ka shkuar te jetojë në Fier.
- Ky fakt hedh poshtë të gjithë aktin e ekspertimit, pasi është bazuar mbi të dhëna që janë të pavërteta, të cilat kanë çuar në një konkluzion plotësisht të pasaktë.
- Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi e provuar me ane të shkresës Nr.2261/1 Prot datë 20.03.2018 të ISSH, se Paditësja [REDACTED] gjatë kohës së shtatëzanisë, nga muaji Prill

2012 deri në muajin Tetor 2012 ka qenë e dypunësuar si në shoqërinë tonë Protec Shoes shpk ashtu edhe në subjekte të tjera punëdhënëse, përkatësisht edhe në subjektet tregtare "Pro Gibs" me NUIS K 16604704 U, subjekti tregtar "Albacall" me NUIS K 92110008 C dhe Subjektin tregtar "Abdurrahim Cibaku" me NUIS L 12022040 Q.

-Duhet të theksojme se gjat procesit gjyqësor, u vërtetua se paditësja e ka marrë njëherë një dëmshpërblim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, "për largim nga puna në kohë të papërshtatshme".

-Referuar nenit 38 të Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi është përcaktuar qartësisht se dëmshpërblimi përfshin ndreqjen e shkeljeve ligjore, përmes kompensimit të duhur ose masave të tjera të përshtatshme.

-Për të gjitha sa u arsytua më sipër, është provuar gjatë procesit gjyqësor se Paditësja [REDAKTUAR] 1-Nuk provon se ka vuajtur nga depresioni; 2- Nuk provon se ka kartelë klinike për ekzaminim dhe trajtim; 3- Nuk provon se ka pësuar dëme pasurore dhe jopasurore nga ky largim nga puna me mbarimin e kontratës; 4-Gjatë gjykimit u provua se paditësja ka marrë dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës në kohë të papërshtatshme nga e njëjta gjykatë; 5- Provohet se ka qenë e dy punësuar në momentin e lindjes;6-Nuk provon që lindja e parakohshme është e lidhur me punën tek pala e paditur;7-Nuk provon se ka qenë papunë, madje provohet se ka rihyrë në tregun e punës në mënyrë të menjëhershme pas 5 muajsh, me pagë më të lartë dhe duke refuzuar të konsumojë plotësisht lejen e lindjes të njohur me ligj.

-Në këto kushte, bazuar në nenin 466 pika "c" të K.Pr.Civile, ankuesi kërkon nga Gjykata e Apelit Tiranë, të vendosë: Pranimin e ankimit, prishjen e vendimit Nr.152, datë 10.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, me tjetër trup gjykues.

Kunder ankimit të mësipërm ka paraqitur apel kundërshtues paditësja, nepermjet te cilit kërkon mospranimin e ankimit, duke pretenduar se:

-Të gjitha pretendimet e ngritura në Ankim nga pala e paditur Protec Shoes sh.p.k. janë një përsëritje e pjesshme e pretendimeve të ngritura në gjykim por që kanë marrë zgjidhje me vendimin përfundimtar të Gjykatës, pretendime te cilat nuk jane të tilla që të çenojnë vendimin.

-Nga njoftimi zyrtarisht nga Administratori i shoqërisë të zgjidhjes së kontratës së punës në monentet e lindjes së fëmijës në kushte të rënda shëndetësore dhe zëvendësimi i saj me një financiar të gjinisë mashkullore është një diskriminim i rëndë që ka pësuar paditësja [REDAKTUAR] nga drejtuesit e shoqërisë "Protec Shoes" shp.k. për shkak të gjinisë, shtatzanisë, dhe gjendjes shëndetësore.

-Me Vendimin Nr.146 dt. 24.09.2014 të Komisionerit per Diskriminim provohet diskriminimi për shkak të gjinisë dhe paafësisë së përkohshme në punë të Znj. [REDAKTUAR] nga ana e shoqërisë "Protec Shoes" shp.k.

-Kërkimi i paditës [REDAKTUAR] për shpërblimin e dëmit të pësuar si pasojë e diskriminimit është i bazuar në nenin 18 të Kushtetutes së Shqipërisë, ligjin Nr. 10221 dt. 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",nenin 625 të Kodit Civil dhe Vendimin nr.12 /207 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

-Gjykata me kerkesën e palës së paditur ka urdhëruar përsëritjen e vleresimit Psikologjik. ku ka caktuar Psikologu [REDAKTUAR], i cili në Raport Vleresimi Psikologjik dt. 31.10.2017 ka përcaktuar se është e evidente që znj. [REDAKTUAR] ka përjetuar çrregullimin e Stresit Post Traumatik pas njoftimit që ka marrë për pushimin nga puna kur ishte në spital.

-Nga pretendimet Kryesore gjatë gjykimit dhe të ankimit nga pala e paditur shoqëria "Protec Shoes" shpk, rezulton se kanë të bëjnë me përjashtimin e Psikologut [REDAKTUAR] për shkak se nuk ishte i regjistruar në organet Tatimore për ushtrimin e aktivitetit privat, por nuk u

kundershtuan konkluzionet e ekspertit të pasqyruara në Raport Vleresim.

-Të gjitha pretendimet e ngritura në ankim nga pala ankuese Shoqëria "Protec Shoes" sh.p.k. nuk kanë të bëjnë me procesin në tërësi, por vetëm me vlerën jopasurore në lidhje me masën e dëmshpërblimit të caktuar nga Psikologu [REDAKTUAR] lekë që duhet të paguajë pala e paditur në favor të palës paditëse [REDAKTUAR]. Të dy Psikologët e caktuar kanë nxjerrë Vlera krejtësisht të përafërta, por Raporti Vleresimit Psikologjik dt.31.10.2017 ka arritur në konkluzion që Vlerën totale e dëmit të shkaktuar ndaj zonjës [REDAKTUAR], të përfshihen edhe familjarët e saj [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] duhet të jetë 6,046,326 lekë.

-Fakti që paditësja [REDAKTUAR] ka qenë e vetëpunësuar si gjatë kohës që punonte pranë shoqërisë "PROTEC SHOES" sh.p.k. ashtu dhe pas largimit të saj padrejtësisht, tregon për Aftesitë e vlerat e saj Profesionale të paditëses, e cila edhe pse është Diskriminuar për shkak të Gjinisë dhe paafësisë së përhohshme në punë të Znj. [REDAKTUAR] nga ana e shoqërisë "Protec Shoes" sh.p.k. është e rivlerësuar në tregun e punës.

-Në kushtet e mësipërme pala Ankuese shoqëria "Protec Shoes" sh.p.k. nuk ka argumentuar se cili është shkak për të kërkuar prishjen e vendimit Civil Nr.152 dt.10.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, për pasojë Gjykata e Apelit duhet të konsiderojë ankimin të pa bazuar.

-Përfundimisht të gjitha pretendimet e ngritura në ankim nga pala e paditur "Protec shoes" sh.p.k., nuk kanë asnjë shkak ligjor për të cënuar vendimin Nr.152 dt.10.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në këto kushte në bazë të nenit 466 germa "a" të Kodit Procedures Civile. paditësja kërkon lënien në fuqi të ketij vendimi.

GJYKATA E APELIT TIRANE

- Pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari **Gramoz Levanaj**,
- dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur, që kerkoi ndryshimin e vendimit duke kthyer çështjen për rigjykim,
- dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, që kërkonte lënien në fuqi të vendimit,
- si e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

- **Vendimi civil Nr.152, date 10.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, është i pabazuar në ligj dhe në prova, ndaj duhet të ndryshohet duke vendosur rrezimin e padisë.**
- Nga materialet e çështjes ashtu siç pretendohet në kërkesën ankimore provohet se, gjykata në gjykimin e kësaj çështje nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, referuar pretendimeve dhe prapësimeve të bëra nga pjesemarresit në gjykim, dokumentacionit të dorëzuar në cilesinë e provës në gjykim dhe dispozitave ligjore përkatëse.
- Nga aktet në dosjen gjyqësore rezultoi se; paditësja [REDAKTUAR], i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, me padinë objekt gjykimi duke kërkuar: *Konstatimin e diskriminimit ndaj paditëses [REDAKTUAR] nga ana e palës së paditur Shoqëria "Protect Shoes" sh.p.k. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Protec Shoes" sh.p.k të dëmshpërblejë palën paditëse dhe familjarët e saj [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për dëmin jopasuror me vlerë totale 6,046,336 leke sipas Raport Vlerësimi Psikologjik*

datë 31.10.2017.

- *Pala e paditur, referuar çështjes objekt gjykimi, në shkallë të parë dhe në ankimin e paraqitur ndër të tjera prapësoi se; Gjykimi në Shkallë të Parë është kryer në kundërshtim me ligjin procedural dhe material sa i takon përcaktimit të vlerës së dëmit jopasuror të kërkuar nga paditësja. Gjykata në kundërshtim me ligjin ka marrë në shyrtime kërkesën e paditëses lidhur me diskriminimin, ndërkohe që ky kërkim është zgjidhur njëherë me vendimin e Institucionit kompetent, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Po kështu gjykata në vendimin e saj ka marrë në konsideratë në cilësinë e provës dy akte vlerësimi të kryera nga psikologë të palicensuar.*
- *Përfaqësuesi i palës paditëse, referuar edhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndër të tjera pretendoi se: vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.*

Rrethanat e çështjes.

- Paditësja [REDAKTUAR] ka qenë e punësuar në Shoqërinë Protect Shoes në detyrën e financieres nga data 18.04.2012 deri në datë 02.07.2013. Me shkresën e datës 02.05.2012, pala e paditur, i ka komunikuar paditëses se me datë 02.07.2013 do të zgjidhë kontratën e punës, pasi në këtë datë përfundon afati i kontratës së punës. Ndërkohë me datë 20.01.2013, paditësja [REDAKTUAR] ka qenë e shtruar në Spitalin Obstretik Gjinekologjik [REDAKTUAR] me diagnozë gravidancë 30-31 javë në gjendje të rëndë për lindje të parakohshme në muajin e 7 (shtatë) të saj.
- Duke pretenduar zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar, paditësja i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila në përfundim të gjykimit me vendimin nr.306 datë 21.07.2014 vendosi: Pranimin pjesërisht të padisë, detyrimin e palës së paditur shoqëria "Protec shoes" shpk, ti paguajë paditëses dëmshpërblim 5 paga mujore duke llogaritur në bazë të pagës mujore bruto. Detyrimin e palës së paditur ti paguajë 2 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit, dhe 2 paga mujore për mosrespektim të procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 21.07.2014, pasi nuk është ankimuar nga palët.
- Referuar zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe detyrimeve për zgjidhjen e këtyre marrëdhënieve kontraktuale, Gjykata Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin nr. 306 datë 21.07.2014 ka pranuar padinë e paditëses [REDAKTUAR] duke konsideruar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të padrejtë nga pala e paditur kundrejt paditëses [REDAKTUAR].
- Gjithshtu paditësja [REDAKTUAR], duke pretenduar se është diskriminuar sa i takon zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme, i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi me ankesën nr.46 datë 19.04.2014.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi pasi shqyrtoi ankimin e palës paditëse [REDAKTUAR] dhe dëgjoi prapësimet e shoqërisë Protec shoes shpk, me vendimin

nr.146. date 24.09.2014 ka vendosur: *1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të gjinisë dhe paaftesisë së përkohshme në punë znj. [REDAKTUAR] nga ana e shoqërisë Protect shoes shpk. 2. Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme nga ana e administratës së Shoqërisë Protect Shoes shpk për njohjen e gjithë punonjësve të kësaj shoqërie me ligjin nr.10221 date 04.02.2010 " Për Mbrojtjen nga diskriminimi".*

- Nisur nga vendimi i marrë nga Zyra e Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, në referim të nenit 608, 625, 640 të kodit Civil, paditësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për shpërblimin e dëmit jopasuror të shkaktuar nga veprimet e shoqërisë "Protect Shoes" shpk.
- Gjatë gjykimit është marrë prova me ekspert, në lidhje me dëmin jopasuror të shkaktuar paditëses, ku nga akt ekspertimet respektive dëmi jopasuror në total llogaritet në vlerën 6.046.326 lekë.

Arsyetimi Ligjor.

- Në Kodin Civil bëhet dallimi midis përgjegjësive kontraktore (Nenet 476 vijues) dhe përgjegjësive jashtëkontraktore (Nenet 608 vijues). Në mënyrë që të kemi përgjegjësi civile për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor duhet të ekzistojnë të gjithë elementët e tij, që janë:
-veprimi apo mosveprimi i paligjshëm;
-faji;
-dëmi;
-lidhja shkakësore.
- Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil, për të patur përgjegjësi civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Lidhja shkakësore është e menjëhershme kur nuk ka ndërhyrë ndonjë faktor tjetër nga moment i sjelljes së paligjshme, deri në atë të shkaktimit të dëmit. Në rastin kur paraqiten disa shkaqe të mundshme, që ka çuar në shkaktimin e dëmit, duhet të përcaktohet se cili ka qenë shkaku determinant. Në raportet e vlerësimit psikologjik përparat nga ana e psikologëve, arrihet në konkluzionin se paditësja vuan nga c'rregullimi i stresit post traumatik. Nga ana e ekspertëve nuk është përcaktuar se shkaku determinant i këtij c'rregullimi ka qenë sjellja e punëdhënësit, duke patur parasysh faktin se paditësja ka patur një lindje të parakohshme dhe ka lindur një fëmijë me probleme. Nuk provohet gjithashtu, lidhja shkakësore midis sjelljes së palës së paditur dhe problemeve me lindjen.
- Në vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.12/2007 parashikohen 3 figurat e ndryshme të dëmit jopasuror (Dëmi biologjik, dëmi moral dhe dëmi ekzistencial). Dëmi moral përkufizohet si: *"shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm"*. Rezulton se paditësja me vendimin nr. 306 date 21.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka përfituar dëmshpërblim për shkak të largimit nga puna në kohë të papërshtatshme.

Dëmshpërblimi i parashikuar nga Kodi i Punës në këtë rast, përfshin edhe dëmin moral që pëson punëmarrësi, si pasojë e largimit të padrejtë nga puna.

- Në lidhje me dëmin ekzistencial ai përkufizohet si: *“Demi i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit që cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thujtë në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qënien e tij apo mund t’i karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Demi ekzistencial, duke mos patur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, është objektivisht i vërtetueshëm”.*
- Nga ana e ekspertëve, bëhet një përshkrim i kësaj figure të dëmit jopasuror, pa përcaktuar nëse paditësja ka pësuar një dëm të tillë, si pasojë e sjelljes së punëdhënësit. Nuk provohet se paditësja nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara.
- Ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi i paditëses [REDAKTUAR], se ajo ka qenë pa punë në periudhën pas lindjes, është i pabazuar. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, vërtetohet se paditësja në muajin Korrik të vitit 2013, ka filluar të punojë me pagë mujore 91.475 lekë, tek punëdhënësi shoqëria "BConnect" shpk me NIPT L 31720003 A, e cila e ka qendren në Tiranë, ndryshe nga sa deklarohet në aktin e ekspertimit që pas lindjes së fëmijes më datë 21.01.2013 për rreth 1 vit ka shkuar të jetojë në Fier.
- Eksperti shprehet se pas lindjes së fëmijës znj. [REDAKTUAR] është trajtuar për c’regullimin e Depresionit nga Psikologe [REDAKTUAR] ku ka kryer gjithsej 52 seanca. Nga ana e paditëses nuk u provua me anë të ndonjë fature tatimore ky fakt.
- Konstatimi i ekspertit që zgjidhja e kontratës së punës është traumatike është i paargumentuar shkencërisht, duke qenë se kontrata ka qenë e lidhur me afat 1 vjeçar dhe pritshmëria e paditëses për kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës pranë palës së paditur ka qenë deri në përfundim të kontratës.
- Në lidhje me vajzen [REDAKTUAR], eksperti shprehet se [REDAKTUAR] shpenzon rreth 5000 euro për çdo trajtim që vajza e saj ben në Rusi, për shkak të problemeve në lindje me shikimin. Ky fakt, përveçse i paprovuar me prova shkresore, nuk ka lidhje me objektin e gjykimit, për sa kohë nuk provohet lidhja shkakësore midis sjelljes së punëdhënësit dhe lindjes me problem të fëmijës.

- Gjate procesit gjyqësor, u vërtetua se paditësja ka marrë njëherë një dëmshperblim me vendim gjyqësor "per largim nga puna në kohë të papërshtatshme ". Referuar nenit 38 te Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskiminimi është përcaktuar se dëmshperblimi perfshin ndreqjen e shkeljeve ligjore, përmes kompensimit të duhur ose masave te tjera të përshtatshme.
- Nga sa me siper, Gjykata e Apelit vlereson se paditesja [REDACTED] nuk provoi pretendimet e saj, lidhjen shkakësore midis sjelljes së punëdhënësit dhe c'rrregullimit nga i cili ajo vuan. Nga ana e saj nuk u paraqit gjithashtu asnjë kartelev klinike për ekzaminim dhe trajtim. Gjithashtu nuk provoi se ka pësuar dëme pasurore dhe dëme të tjera jopasurore nga largimi nga puna.
- Gjithashtu gjatë gjykimit u provua se paditesja ka marre dëmshperblim për zgjidhjen e kontratës në kohë të papërshtatshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë; Nuk provon që lindja e parakohshme ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të palës së paditur.
- Nisur nga këto konsiderata juridike nga Gjykata e Apelit Tiranë arrihet në përfundimin se, vendimi Nr.152, date 10.04.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, duhet të ndryshohet duke u vendosur rrëzimi i kerkese-padisë.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Tiranë bazuar në nenin 466/a te K.Pr.Civile,

VENDOSI

-Ndryshimin e vendimit civil Nr.152, datë 10.04.2018 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

-Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë

Tiranë me, 25.11.2020

ANETAR

Asim VOKSHI
d-v

ANETAR

Ridvan HADO
d-v

KRYESUES

Gramoz LEVANAJ
d-v

Vertetohet njesia me originalin
Kryesekretare
Rudina MAHMUDA